



Republika e Kosovës
Republican Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura e V-të

Komisioni për Buxhet dhe Financa

Mbledhja nr. 38/15

Prishtinë, më 08.12.2015, ora 12:30

Ndertesa e Kuvendit të Kosovës, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Ne mbledhje morën pjesë: Naser Osmani, Safete Hadergjonaj, Labinote Demi-Murtezi, Besa Gaxherri, Jelena Bontic dhe Bardhyl Meta.

Munguan: Ilir Deda, Enver Hoti dhe Bali Muharremaj dhe Fikrim Damka.

Pjesëmarrës të ftuar: Avdullah Hoti – Ministër i Financave, Agim Krasniqi- Zëvendës-Ministër i Financave, Salvador Emlazi- Drejtor i Departamentit të Buxhetit Qendror në Ministrinë e Financave.

Gjithashtu të pranishëm ishin: Rejhane Zylfijaj - nga GIZ.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Iseini, Luljeta Krasniqi, Dashurije Canolli, Medina Agushi (praktikante).

Mbledhjen e kryesoi: Naser Osmani, Kryetari i Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i Raportit me amendamente të Komisionit për Buxhet dhe Financa për Projektligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016;
3. Rishqyrtimi i Raportit me amendamente për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin në Ligjin Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjet Nr. 03/L-221, Nr. 04/L-116 dhe Nr. 04/L-194;
4. Shqyrtimi i Projektligjit për Ratifikimin e Marrëveshjes së Kredisë ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Unicredit Bank Austria AG për Financimin e Projektit të Modernizimit të Shërbimeve të Kardiologjisë Invazive në Qendrën Kilinike Universitare të Kosovës;
5. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari - konstatoi se rendi i ditës miratohet pa ndryshime.

2. Miratimi i Raportit me amendamente të Komisionit për Buxhet dhe Financa për Projektligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016

Kryetari- njoftoi që kemi një kërkesë nga Ministria e Kulturës për rregullime brenda Buxhetit të Ministrisë. Në kërkesën e parë është kërkuar që nga projekti renovimi i stadiumit të qytetit në Prishtinë të merret shuma prej 110,000 euro dhe të transferohet në projektin renovimi i stadiumit "Adem Jashari" në Mitrovicë. Kërkesa e dytë ka të bëjë që nga projekti 'Objekti Teatër dhe Opere dr. Ibrahim Rugova, të merren 50,000euro dhe nga projekti "Renovimi i teatrit Kombëtar" të merren 20,00euro, dhe shuma prej 70,000 euro, nga keto dy projekte të bartet në projektin e ri "Ndërtimi i Shtëpisë së Kulturës në Obiliq".

Agim Kransiqi - propozoi që në amendamentin 29, pika 3 të shtohet teksti "Për projektin Për avansimin e teknologjisë", në tabelën 3.2."

Komisioni njëzëri miratohi kërkesën e Ministrisë së Kulturës për rregullime të brendshme brenda buxhetit të Ministrisë si dhe përkahu propozimin e zv.ministrit të financave që në amendamentin 29, pika 3 të shtohet teksti "për projektin "Për avansimin e teknologjisë", në tabelën 3.2."

Pas diskutimeve dhe propozimeve, kryetari konstatoi se komisioni njëzëri nxori këtë

Rekomandim

Miratohet Raporti me amendamente për Projektligjin e Buxhetit Kosovës për vitin 2016 dhe raporti me amendamente procedohet për shqyrtim dhe miratim në procedurat të metutjeshme në Kuvend.

3. Rishqyrtimi i Raporit me amendamente për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin në Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjet Nr. 03/L-221, Nr. 04/L-116 dhe Nr. 04/L-194

Kryetari - theksoi se në amendamentin 3, pika 22.A.7, ka pasur në tekstin që kemi shtuar në fund ka pasur vëretje nga FMN, ku është kërkuar që të fshihet kjo pjesë. Prandaj, propozojë që në amendamentin 3, pika 22A.7 të fshihet teksti „ për qëllim të këtij neni, projekt kapital konsiderohet projekti që përbëhet së paku 80% e shpenzimeve të kategorisë së investimeve kapitale."

Pas sqarimeve, Kryetari konstatoi se komisioni njëzëri nxori këtë

Përfundim

1. Në amendamentin 3, pika 22A.7, fshihet teksti "për qëllim të këtij neni, projekt kapital

konsiderohet projekti që përbëhet së paku 80% e shpenzimeve të kategorisë së investimeve kapitale”.

2. Raporti me amandamente procedohet për shqyrtim dhe miratim në procedura të metutjeshme në Kuvend.

4. Shqyrtimi i Projektligjit për Ratifikimin e Marrëveshjes së Kredisë ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Unicredit Bank Austria AG për Financimin e Projektit të Modernizimit të Shërbimeve të Kardiologjisë Invazive në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës

Avdullah Hoti - theksoi se Qeveria e Kosovës ka një marrëveshje të nënshkruar me Qeverinë e Austrisë për një kredi prej 20,000,000 euro, për financimin e projekteve të ndryshme në nivel qendror dhe lokal. Ministria e Shëndetësisë ka shfaqur një interesim për negocimin e një kredie prej 2.6 milion euro për modernizimin e qendrës invazive në QKUK që është blerje e pajisjeve dhe aparturave për nevojat e kardiologjisë invazive në QKUK. Kemi të bëjmë me një kredi eksportuese që është në buxhet të Minsitrisë së Shëndetësisë për këtë vit dhe është brenda rregullës fiskale. Nëse arrijme ta ratifikojmë marrëveshjen këtë vit, këto pajisje do të vijnë brenda këtij viti.

Pas sqarimeve, Kryetari konstatoi se komisioni njëzëri nxori këtë

Rekomandim

I rekomandohet Kuvendit të miratojë Projektligjin për Ratifikimin e Marrëveshjes së Kredisë ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Unicredit Bank Austria AG për Financimin e Projektit të Modernizimit të Shërbimeve të Kardiologjisë Invazive në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës.

Mbledhja përfundoi në ora 13:15

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Naser Osmani